



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E DREJTËSISË  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PËRMBARIMIT  
ZYRA PËRMBARIMORE KURBIN

Nr. 1713 Prot.

Laç, me 02.04.2019

**V E N D I M - S H P A L L J E**

**(Lidhur me ekzekutimin e "Urdherit të Ekzekutimit" të titullit ekzekutiv të debitorit)**

Ne Lac, sot me date 02.04.2019

Une, Mikeda Cenaj, me detyre Permbarues Gjyqësore pranë Zyres Permbarimore Kurbin, pasi studiova aktet proceduriale të çështjes permbarimore Nr.389 rregjistri themeltar të vitit 2019 bazuar në Urdherin e ekzekutimit të datës 28.01.2019 të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Kurbin,

**KONSTATOVA:**

Se në datë 20.02.2019 është depozituar pranë Zyres së Permbarimit kërkesa e kreditorit Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Kurbin së bashku me "Urdherin e Ekzekutimit" të Titullit Ekzekutiv (vendim gjyqësor penal) nr. 617-79 të datës 13.04.2017 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin, me palë dhe objekt:

- Kreditor: Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Kurbin
- Debitor: Zenel Mustafa Lika i dtj. 29.12.1959 me banim në Shullaz
- Me objekt: Pagim shpenzime proceduriale + tarifë fikse permbarimore.

Nga ana e zyrës tona permbarimore kanë filluar procedurat në bazë të nenit 515 e vijues të K.Pr.Civile si dhe ligjit 8730 datë 18/01/2001 "Për Organizimin dhe Funkcionimin e Sherbimit Permbarimor Gjyqësor" i ndryshuar për ekzekutimin e detyrueshëm të Titullit Ekzekutiv të sipercituar.

Nga verifikimi i kryer nga ana jone në bashkëpunim me organet kompetente rezultojnë se debitori Zenel Mustafa Lika i dtj. 29.12.1959 nuk merr dijëni nepermjet sherbimit postar dhe si rezultat i kesaj bazuar në nenin 133/a, 133/b dhe 144/a si dhe 517 të K.Pr.Civile duhet të bëhet njoftimi me shpallje publike i debitorit lidhur me detyrimin që ai ka ndaj palës kreditore Prokuroria Rr.Gj. Kurbin për shpenzimet proceduriale dhe tarifën fikse permbarimore në masën 8000 leke.

Sa me sipër në mbështetje të Nenit 133/a, 133/b dhe 144/a si dhe 517 të Kodit Procedures Civile, ligjit Nr.8730 datë 18/01/2001 "Për Organizimin dhe Funkcionimin e Sherbimit Permbarimor Gjyqësor", i ndryshuar

**V E N D O S A**

1-Te kryej njoftimin nepermjet shpalljes publike me afat 20 (njetzet) ditore (duke mare parasysh edhe komunikimin postar) nga data 02/04/2019 - 21/04/2019 të debitorit Zenel Mustafa Lika i dtj. 29.12.1959 me banim në Shullaz

2-Ky vendim perpilohet në disa kopje, ku një kopje afishohet në vendbanimin e fundit të palës debitore, një kopje afishohet në këndin e njoftimeve të kesaj zyre, një kopje dërgohet për afishim në ambjentet e Njësise Administrative Milot, një kopje dërgohet për afishim në ambjentet e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin dhe një kopje i dërgohet për publikim në faqen zyrtare të Drejtorisë së Përgjithshme të Permbarimit Tirane.

3-Kjo shpallje publike ka vlerën e aktit të njoftimit për palën debitore Zenel Mustafa Lika i dtj. 29.12.1959 me banim në Shullaz

4-Palë debitore Zenel Mustafa Lika i dtj. 29.12.1959 me banim në Shullaz, duhet të paraqitet pranë Zyres Permbarimore Kurbin me seli në Lgji nr.4, Lac në katin e parë në ambjentet e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin dhe të marrë kontakt me permbaruesin gjyqësor të çështjes permbarimore për t'ju vene në dispozicion aktet permbarimore, pasi me kalimin e këtij afati do të vijohet me ekzekutimin e detyruar sipas parashikimeve të nenit 519 e në vijim të K.Pr.Civile.

U shpall, sot me date 02.04.2019.

PERMBARUES GJYQËSOR  
MIKEDA CENAJ

